

**MANDARIN-CHINESE, ALBANIAN AND ENGLISH VERBS, SEEN FROM THE
PERSPECTIVE OF THE GRAMMATICAL TENSES**

Florim AJDINI

University of Tetova, Faculty of Philology, English Language and Literature
florim.ajdini@unite.edu.mk

UDC 811.581(091)

UDC 811.111:811.18

Conference paper

Abstract

Different from English and Albanian, verbs in Chinese-mandarin, do not conjugate across pronouns who perform the action. They have no inflectional nature and features in none of the grammatical tenses which are in the focus of this paper. The Chinese verbs never go through case and person! This phenomenon, in a way makes life easier for the non-native learner of Chinese, not having to remember all verb particles in order to create the time effect, to express an action. It makes easier for the learners of this ‘mega language’, spoken by more than **1.400.000.000** people, to learn it easily. Given this, the word order in Chinese sentences is, very crucial.

This order is the only alternative, to show the foreign learner, the effect of the relationship between the subject and the verb. Furthermore, the word order, changes compared to the one in Albanian and English, especially in cases when we have to deal with actions asking questions of interrogative character, with the so called magic word ‘MA’, which in a way remain the same as the affirmative or declarative ones. This paper, through a detailed comparative analysis, aims to put in focus the so called irregularities in Chinese–Mandarin, or ‘Putonghua’=(普通話”), as to how tenses, are expressed in this language, using also the Romanized pin-yin letters.

Key words: *Verbs, case, tense, comparison, Albanian, English and Chinese.*

Përbledhje

Kinezishtja, gjuha „më e madhe“ e rruzullit tokësor, e folur nga 1.400.000.000 folës kinezë, për dallim nga anglishtja dhe shqipja, në nivel të kohërave gramatikore, mënyrës se si ato formohen dhe çfarë ndryshimesh pëson baza e foljes, rezulton ndryshe. Foljet e “mandarinit”, nuk zgjedhohen nëpër veta! Ato nuk kanë natyrë infleksionale në kohët që do të jenë në fokus të këtij punimi. Kjo kategori e ndryshueshme gramatikore, nuk preket nga faktorët, si: koha dhe veta! Kjo ia lehtëson nxënësit jo-kinez, mbajtjen mend të formimit të kohërave në fokus të këtij punimi, ngase paraqet një perceptim të lehtë të tyre.

Thjesht, foljet nuk marrin prapashtesa, dhe efekti kohor del i njëjtë për kohëra të ndryshme, përderisa atë nuk e ndryshon ndonjë ndajfolje, datë apo vit, apo prefiksi magjik ‘MA’. Sidoqoftë, rendi i fjalëve në fjalitë në kinezishtë është shumë i rëndësishëm. Ky rend, është e vetmja mënyrë për t’i treguar nxënësit efektin e raportit ndërmjet kryefjalës dhe kallzuesit, apo kush çfarë bën dhe mbi kë bie veprimi i foljes.

Nga ana tjeter, fjalitë ndryshojnë nga anglishtja në shqip, në rastet e përdorimit të fjalive pyetëse, të cilat mbeten të njëjta, sikur fjalitë dëftore ose deklarative, që nuk është e rastit në anglisht dhe shqip. Ky punim, nëpërmjet të analizës krahasimore, me fokusim në rendin e fjalëve dhe foljeve si kryerëse veprimi, ka për qëllim të vë në pah këtë “konstrukt kohor” të kinezishtes, siç njihet me termin ‘**Putonghua**’= gjuha e popullit (**普通話**).

Fjalët kyçe: *Foljet, veta, koha; krahasim, shqip, anglisht dhe kinezisht.*

Hyrje

Pak histori të Kinezishtes Mandarine

Kinezishtja Mandarine, njihet gjithashtu edhe si gjuha Huayu (華語), e kinezishtes së vjetër, Guoyu (國語), gjuha zyrtare, apo Putonghua (普通話), gjuha e popullit, është gjuha zyrtare e shtetit kinez duke filluar nga viti 1982. Në Taiwan, Kinezishtja - Mandarin, filloi të përdoret shumë më herët si gjuhë zyrtare e vendit, edhe atë, nga viti 1932. Kinezishtja Mandarine, është gjithashtu edhe njëra nga katër gjuhët zyrtare në Singapur, sidhe njëra nga tetë gjuhët zyrtare të OKB-së.

Nëse kthehem pas në historinë dhe civilizimin e këtij populli të madh dhe të fuqishëm, ai shtetin e tij e konstituoi që nga viti 221, para epokës sonë. Që atëherë dhe deri në vitin 1912, pra, në kohën e udhëheqjes së vendit nga ana e dinastisë së fundit imperiale, Kina nuk pati ndonjë gjuhë zyrtare të unifikuar si gjuhë që do përdorej në tërë vendin.

Kjo nënkupton që kinezët, kanë folur gjuhë të ndryshme dhe dialekta, që në fakt u zhvilluan vetveti gjatë rrjedhës së shekujve. Diku nga shekulli i XX, kinezët pranuan dhe u pajtuan me faktin që duhej të kishin një gjuhë të përbashkët, gjë kjo që do të lehtësonte komunikimin deri në pjesët më të largëta të shtetit, dhe që si e tillë do të luftonte analafabetizmin.

Në shkurt të vitit 1913, shteti i ri i posaformuar; Republika e Kinës, (**中華民國**), formoi Këshillin kombëtar për unifikimin e leximit të tingujve dhe fjalëve kineze, të një gjuhe të përbashkët, që u mbajt në Peking. Kjo çoi drejtë formulimit të një sistemi të përbashkët fonetik dhe së fundmi gjuhën e vetme zyrtare të standardizuar kineze. Këshilli në fjalë, përfshiu intelektualë, linguist dhe politikanë nga të gjitha teritoret e Kinës, si; Tibeti, Kina, Mongolia dhe komunitetet tjera kineze, tejoqeanike.

Ndër detyrat themelore të Këshillit, ishin si vijon; të krijohet një sistem fonetik lehtësisht i lexueshëm, i cili do t'u mundësonte kinezëve kudo që ishin të mësojnë dhe lexojnë lehtë gjuhën e unifikuar kineze ose Mandarin. Shumë propozime ranë, por më së fundmi këshilli në fjalë, ndërmjet tyre edhe përdorimi i alfabetit Latin, por më në fund Këshilli vendosi që si alfabet unik i kinezishtes së jetë ai Zhuyin, kjo nga fakti sepse mendohej që i njëjti ishte me i kapshëm dhe me i lehtë për realizimin e një mësimdhënie dhe nxënie më të kapshme të kësaj gjuhë për të gjithë njëlloj (Chen, Keh-Jiann, Shu-Ling Huang, Yueh-Yin Shih, Yi-Jun Chen, 2005).

Më tej, Këshilli në fjalë, batoi të ashtuquajturin Fjalor kombëtar fonetik për leximin e unifikuar të kinezishtes. Ky fjalor, u bazua në dialektin më të fuqishëm në përdorim, atë të Pekingu. Në vitin 1932, në Republikën e Kinës (**中華民國=Zhōngguó gōnghéguó**), filloi projekti i Këshillit në fjalë, i njojur me emrin Guoyu ose Mandarin, që në fakt prezantoi përfundimisht para kineze Fjalorin gjithpërfshirës në gjuhën Mandarin, si fjalor i gjuhës Kineze, gjuhë zyrtare për të gjithë kinezët.

Në vitet që pasonin, posaçërisht në vitin 1949, Republika Popullore e Kinës, (**中華人民共和國=Zhōnghuá rénmín gōnghéguó**), filloi me promovimin e Kinezishtes Mandarin. Në vitin 1955, Këshilli ndryshoi emrin kinez për Mandarin, nga Guoyu në Putonghua. Në fakt, për të qenë më i qartë, më duhet të them që emrat; Guoyu, Putongua, dhe Huayu, thjeshtë janë emra të ndryshem të kinezishtes, për gjuhën e njëjtë. Pra, Kinezishtja Mandarine! Diku ka viti, 1982, Republika Popullore e Kinës, ndryshoi Kushtetutën e vendit me ç'rast emëroi Mandarin-in, gjuhë ayrtare të Kinës kontinentale (Chen, Yi-Jun, S. Huang, Y. Shih, and K. Chen: 2005).

Përjashtim për statusin e saj, sot kemi vetëm në Taiwan, ku Mandarin, nuk ka efekt juridik, si që e ka të njëtin në Kinë. Një politikë e këtillë gjuhësore, bëri që sot, pas 70 vitesh, Mandarin, ne mënyrë të rrjedhshme të flet 70% e tërë popullsisë kineze, me tendenca që kjo përqindje të rritet edhe më tej.

Fenomeni i trajtuar dhe metodologja e punës (Hipoteza e ngritur)

Fakti që kinezishtja-mandarine, si gjuhë kryesore e familjes Sino-tibetiane të gjuhëve, ka një numër të caktuar të karakteristikave që vënë në shprehje dallimet ndërmjet gjuhëve të kësaj familje dhe familjes Indo-europiane, është njëra nga arsyet themelore që të realizohet ky punim. Në fakt fjala është për kategorinë gramatikore të foljes dhe zgjedhimit të saj nëpër veta dhe kohë gramatikore, proces ky që në kinezishten-mandarine, nuk ekziston! Shtrohet pyetja, si mundet atëherë kjo gjuhë e madhe të krijojë efektin semantik të foljeve të saja nëpër veta dhe kohë gramatikore, qofshin nga ato kohë që shprehin efekt kohor të tashëm, të kryer, të ardhëshëm apo çfarëdo efekti kohor që folësi i huaj ka nevojë të përdorë. (Dong, Zhendong & Dong Qiang, How Net, Fellbaum, Christiane:1998).

Andaj, hipoteza e ngritur është direkt e lidhur me çështjen nëse aspekti kohor i anglishtes dhe shqipes, si gjuhë krejtësisht të ndryshme nga kinezishtja, mund të realizohet ashtu siç bëhet kjo në këto gjuhë, apo thjesht, këndvështrimi i veprimit në kontekst kohor, është alternativa? Personalisht, si nxënës i kinezishtes, mandej si linguist dhe filolog, mendoj që Gramatika kineze, është shumë më e thjeshte se sa ajo angleze, ndërsa tejmase më e thjeshtë se gramatika e gjuhës shqipe.

Kjo nga fakti, që në baza të asaj që mësoj si fillestar, pra nxënës me njohuri jo të mjaftueshme të kësaj gjuhe, mund ta ndjej potencialin rekursiv, respektivisht prodhues të kësaj gjuhë, krahasuar me shqipen dhe anglishten. Në kinezisht, në formimin e fjalive dhe shprehjen e një kohe të caktuar gramatikore, folja qëndron me një status të fiksuar dhe të ashtuquajtur joproduktiv, apo rekursivisht jofleksibël. Kur flasim përfoljet e kësaj gjuhe, mund të them që një numër i madh i tyre karakterizohet me një status të tillë, që në fakt, shkallën e ulët të prodhimtarisë efikase kohore të foljeve, e bën pa përdorur format apo konstruksionet e kohës, numrit vetës etj., që imponohen nga vetë kryefjala.

Dukuria e këtillë, flet për nivel të ulët të të ashquajturit infleksionalitet apo reproduktivitet morfolistik që sigurohet me përngjiturë të afiksave foljorë, qofshin këto të pozicionohen përparrë apo pas saj. (Chao, Yuen Ren, 1968). Në fakt, kjo mund të shpjegohet me faktin që gramatika kineze, më së shumti merret dhe favorizon qasjen ose çështjen se si foljet rradhiten dhe me çfarë duhet të shoqërohen, ashtu që ato të jepin efektin e duhur kohor në fjalitë e caktuara me të cilat

folësi shpreh kohën në të cilën një veprim i caktuar foljor u realizua. Një qasje e këtillë, është e vetmjë mënyrë se sin ë kinezishten mandarine, realizohet efekti kohor i veprimit të foljes, që në fakt është krejtësisht ndryshe nga ajo që bëhet në shqipe ose në anglishtë.

Kjo është strategjia e vetme se si në kinezishten mandarine, formulohen fjalitë me kuptim të plotë kohor, dhe të cilat nga folësit e lindur aspak nuk parqesin ndonjë problem të nxënies, ngase në këtë drejtim, mund të thuhet, që shikuar nga aspekti i gjenetikës gjuhësore, folësit kinez, këto elemente të nxënies, i realizojnë si rezultat i elementeve nxënëse që i vijnë që nga lindja e tyre. Në rastin e nxënësve të huaj të kësaj gjuhë, qoftë ajo gjuha e dytë apo e tretë, nxënia e këtyre formave kohore të foljeve në fjalitë në të cilat këto folje ndodhen, mësohen me vormë mekanike dhe rutinore, përderisa, nxënia a tyre asimilohet dhe mund të përshruhet si motorike apo sensori-motorike.

Në anën tjetër, për të realizuar punimin në fjalë, për analizë po marrim disa folje në mandarin, në anglisht dhe në shqip, të përdorura në kohërat gramatikore, si : koha e tashme, koha e kryer e thjeshtë dhe koha e ardhme. Në fokus të analizës është rendi i fjalëve në fjalitë e kinezishtes, me theks të veçantë në mënyrën se si në këto fjalë, është shprehur efekti kohor, i foljeve që janë përdorur. Për të arritur të sigurohet një sqarim më i thjeshtë lidhur me fenomenin në fjalë, fjalitë e përdorura janë analizuar sipas metodës krahasimore me theks në rradhitjen e fjalëve dhe përdorimin e formave-fjalëve që në fakt përdoren për t'u arritur efekti i kërkuar, i cili për dallim nga kinezishtja, në shqip dhe anglisht, realizohet ndryshe.

Pjesa analitike-të dhënat

Për të realizuar punimin në fjalë, më është dashur të nisem nga pjesa që vet personalisht, si nxënës-studiu i huaj i kinezishtes, e kam të njobur, kjo për vetë faktin që njobjet aktuale të miat në këtë gjuhë janë në zgjerim e sipër, dhe si të tillë, në fokus është analiza e këtyre nxënieve, shikuar nga konteksti dhe perspektiva e gramatikës gjenerativiste, që si rregull gjuhësore funksionon edhe në reprodukimin komunikativ në fazën e mësimit të kinezishtes-mandarine, që në fazat e hershme. Aspekti i sintaksës rekursive, gjithashtu është vënë në qendër të analizës teorike dhe praktike të fjalive të përdorura si material hulumtues.

Kjo nga vetë fakti që si linguist, e kam më të lehtë të përqëndrohem ne qartësimin e efektit kohor dhe atë të vetës që foljet e kinezishtes e shprehin sipas modelit në funksionim të kinezishtes standarde. (Hsing, Jen-Chieh:2003). Në kontekstin praktik të nxënies së kinezishtes, për të huajt, siç është edhe rasti im, theksi i veçantë është vendosur në faktin që edhe kinezishtja si gjuhë, posedon aftësinë e ashtuquajtur të fleksibilitetit rekursiv në nivel të fjalisë, për të mundur të prodhojë apo gjenerojë një numër të caktuar fjalishë, gjithmonë të bazuara në

rregullin e gramatikës rekursive-gjenerative të Chomsky-t, vazhdimesht të bazuar në fenomenin e gjenerativizimit praktik të këtij linguisti, por edhe në qasjen time si nxënës konkret i gjuhës në fjalë, (Hong Wei-mei: 1991).

Nga krejt kjo, si nxënës-studiu i huaj i kinezishtes mandarine, për ta bërë analizën time më të prekshme dhe me reale, në qendër të saj, kam vënë 6 fjali me 6 folje dhe 3 kohëra të ndryshme gramatikore, pikërisht ashtu siqë u cek edhe më lart. Sa u përket mënyrave follore të cilat janë përdorur, për të qenë më konkret në shpjegimin e fenomenit në fjalë, janë përdorur : mënyra dëftore dhe ajo pyetëse e fjalive dhe foljeve në fokus të hulumtimit.

Aspekti kohor i foljeve, në fokus të analizës:

Kinezishte-Mandarine	Shqip	Anglisht
Mënyra follore Dëftore	Koha koha e tashme / veta	Koha koha e tashme /veta
Wǒ shì lǎo shī. 我是谢老师	Unë jam mësues.	I am a teacher.
Tā shì lǎo shī. 他是老师	Ai/Ajo <u>është</u> mësues.	He/She is a teacher.
Wǒ shì Zhōngguó rén. 我是中国人	Unë jam kinez.	I am Chinese.
Nǐ shì lǎoshī. 你是老师	Ti je mësues.	You are a teacher.

Tabela Nr.1 Shembull ilustrues foljeve në mënyrën dëftore

Nga ajo që mund të shihet nga shembujt e mësipërm, në kinezishten mandarine, folja për dallim nga shqipja por edhe nga anglishtja, ngel në formë të njëjtë për të gjitha vetat. Forma në fjalë, është: **Wǒ / Nǐ/ Tā/SHÌ lǎoshī/你是老师.**

Kinezishte-Mandarine	Shqip	Anglisht
Mënyra foljore - Dëftore Tā zuótiān qù yīn gguó 他昨天去英国	Koha e kryer Ai shkoi në Angli (dje). He went to England (yesterday)	Koha e kryer
Tā qù nián qù Yīng Guó 他去年去英国	Ai shkoi në Angli, (vitin e kaluar). He went to England (last year)	
T q Guo Yīn Gu ā ù g ó 他去过英国	Ai ka qenë (më parë) në Angli. He has been to England (before)	

Tabela Nr. 2 Shembull ilustrues i foljeve në mënyrën dëftore të kohës së kryer

Nga ajo që mund të shihet nga shembujt e mësipër, konstatohet që në kinezishten mandarine, nuk ka shprehje të kohës së ardhëshme (Liao, Wei-wen: 2005). Për të realizuar këtë efekt kohor, përdoren fjalët special, si: ndajfolje kohe, ose emra të catuar, ose folje ndihmëse, si p. sh.: dje, pardje, vitin e kaluar, para dy orësh, etj. Në fakt kinezishtja, efektin kohor të së kryerës e shpreh nëpërmjet të kontekstit që flet për kohën e kryer, me theks në kohën kur ngjarja ndodhi, që në fakt është krejtësisht ndryshe nga formimi i kësaj kohe në shqip dhe anglisht. Dhe për çudi, ndonjëherë, madje as që duhet të potencosh efektin e foljes në të kaluarën.

Efekti i fjalëve (ndajfoljeve, emrave etj.), që shprehin kohën e ngjarjes

Një fakti i këtillë, e bën shumë të lehtë vendosjen e ngjarjes në kontekstin kohor, që në kinezisht nuk ekziston. Kjo përfaktin, që varësisht nga konteksti i ngjarjes, pra, kur asaj i referohemi, thjesht folësit e kinezishtes, nuk ndjejnë nevojën ta ndryshojnë fjalinë që artikulojnë (Hong Wei-Mei: 1991).

Ndërsa në shqip, efekti kohor i foljes, nuk arrihet si në kinezisht. Fjalia pa përshtatje të foljes në kohë dhe në vetë, e madje edhe në numër, sipas folësit, nuk mund të imagjinohet. Situatë të njëjtë kemi edhe në anglishtë.

昨天 (zuótiān): yesterday

我昨天在食堂吃饭了。

Wǒ zuótiān zài shítáng chīfàn le.

Yesterday I eat in the canteen =Dje, une drekoj në kantinë

我昨天遇见了他。

Wǒ zuótiān yùjiàn le tā.

I bump into him yesterday =Dje, rastësish has në atë!

昨天发生了一件有趣的事。

Zuótiān fāshèngle yī jiàn yǒuqù de shì.

Something interesting happen yesterday =Dje ndodh diçka interesante!

Pra, foljet në kinezishten mandarine, nuk zgjedhohen aspak, dhe kjo bën që ato të mos kenë kohë të kryer apo të ardhme, madje as shprehjen e numrit të kryerësit të veprimit nëse është njëjës ose shumës. Nga shembulli më sipër, ku kemi foljen ‘me pi’ ose ‘drink’, por nuk ka forma që egzistojnë si në shqipe, si: të pish, duke pirë, piva, do të pi etj.

Kinezishte-Mandarine	Shqip	Anglisht
Mënyra foljore - Dëftore	Koha e ardhme	Koha e ardhëshme
我们会喝咖啡 Wǒ men huì hē kāfēi *huì=parashikim	Ne (do ta) pimë kafe (nesër).	We (will) drink coffee (tomorrow).
Tā míng tiān qu Yǐng Guó 他 明 天 去 英 国	Ai (do të) shkojë në Angli (nesër).	He (will) go to England (tomorrow).

Rezultate nga analiza komparative e kohëve në fokus

Fjalitë pyetëse: **tā shì lǎo shī ma?** 他是老师吗？ Is he a teacher? Ajo është mësuese, apo jo? Ndërsa jo: A është ajo mësuese? Pra, kemi mungesë të aspektit të gjinisë, ndërsa forma-agjenti pyetës, vëndoset vetëm në fund. Në vend të zgjedhimit të foljeve, në kinezishten mandarine, ajo që ndihmon krijimin e kontekstit kohor, në fjalitë që prodhohen, është përdorimi i ndajfoljeve të kohës si: nesër, tani dhe pjesoret që perdoren në kinezishte, që janë të veçanta dhe krijojnë sensing e perceptimit kohor, që më lehtë kuptohet nga ana e folësve të lindur, kjo përfaktin që e kanë gjuhë amtare dhe kjo nënkuption që këto struktura janë të lidhura me ‘innateness’ (efekti gjenetik), të Chmsky’t dhe impaktin e gramatikës së tij gjenerativiste. Situata paraqitet si vijon:

1. He will go to England tomorrow =Nesër, ai shko në Angli.

tā míng tiān què yīng guó 。
他 明 天 去 英 国 。

Kryefjale- Ndajfolje -Folje - Objekt

2. He went to England last year =Ai shko në Angli, vitin e kaluar.

tā què nián què yīng guó 。
他 去 年 去 英 国 。

Kryefjale- Ndajfolje -Folje - Objekt

3. He has been to England before=Ai shko na Angli më herët.

tā què guò yīng guó 。
他 去 过 英 国 。

Aspekte konkrete të rrezultateve

Aspekti kohor i foljes në kinezishten mandarine, si mënyrë për të shprehur “kohën gramatikore.” Të gjithë ato to cilët e mësojë këtë gjuhë, në fazën e hershme, ballafaqohen me faktin e çuditshëm që në kinezishten mandarine, nuk paska kohë foljore! Pyetja që parashtrohet, gjithnjë është: Si atëherë formohen kohët gramatikore të së ardhmes dhe të së kaluarës, qofshin ato kohëra të thjeshta ose të përbëra?

Si bëhet efektuimi kohor i aksionit që shpreh një folje e caktuar, nëse diçka do të ndodh nesër, apo pasnesër apo vitin e ardhshëm, apo thjesht të të ardhmen? Apo nëse diçka ka ndodhur dje, në të kaluarën, etj. Nga hulumtimet e realizuara me fjalitë dhe foljet në fokus, ky fenomen mund të shpjegohet me “aspektin foljor”, i cili zëvendëson kohën gramatikore. Këtu duhet duhet thënë konkretisht që foljet në anglisht apo në shqipe, kanë një formë të vetme, që në fakt verifikon faktin që ato në të shumtën e rasteve nuk ndikohen nga infleksioni, gjë kjo që nuk është e rastit me shqipen, ku hasim më shpesh fenomenin e infleksionit, apo prapashtesimit të foljeve, në të gjitha kohët dhe mënyrat. Për ta ilustruar këtë, nga shembujt e mësipër, marrim shembul foljen “të shkosh” apo në anglisht “to go”.

Format tjera si: went, gone, am going, will go, thjesht asgjë më tepër përvëç: ‘go.’ E njëjtë vlen edhe për shqipen. Pra, asgjë më tepër përvëç: “të shkosh.” Versioni kinezisht, në anglishtë do të dukej kështu:

I go Beijing. -----Unë shko në Peking.

She go Beijing. -----Ajo shko në Peking.

We go Beijing. -----Ne shko në Peking.

Ndërsa në shqipe do përkthehej si vijon:

<p style="text-align: center;">明天我去北京。 míng tiān wǒ qù běi jīng. Tomorrow I go Beijing.</p>
<p style="text-align: center;">現在她去北京。 xiànl zài tā qù běi jīng. Right now she go Beijing.</p>
<p style="text-align: center;">去年我們常常去北京。 qù nián wǒ mén cháng cháng qù běi jīng. Last year we often go Beijing.</p>

Përshkrimi kualitativ i situatës, kundrejt gjuhës shqipe dallon dhe paraqitet si vijon:

Rasti i parë:

Ming tian wo qu bei jing = Nesër unë shko në Peking.

Kjo strukturë, nuk është kuptomplate dhe gramatikisht korakte. Prapëseprapë, ajo dhe shpreh veprimin foljor në kontekstin kohor të së ardhmes. Në gramatikën tonë njihet si e **ardhmja në të tashmen**, që shprehet nëpërmjet të ndajfoljes së kohës ‘nesër’, pa përdorur formën **do të**, si **agjent-aspekt kohor**. Sa u përket prapashtesave që karakterzojë veten follore, ato në kinezisht nuk ekzistojnë, në asnje kohë gramatikore.

Rasti i dytë:

Xian xai ta qu bei jing = Tani ajo shko (në) Peking!

Kjo strukturë, NUK është kuptomplate dhe logjike, ndërsa si e tillë, gramatikisht jokorrekte!

Ajo shpreh veprim foljor në kontekstin kohor të së tashmes, por ajo që vret veshin është pajtimi i foljes për vetën e tretë (gjinia femërore). Në gramatikën tonë njihet si koha e tashme, që shprehet edhe nëpërmjet të ndajfoljes së kohës ‘tani’, por edhe nëpërmjet të pajtimit të foljes në vetë, që nuk është rasti në kinezishte. Sa u përket prapashtesave që karakterizojë veten follore, ato në kinezisht nuk ekzistojnë, nëasnje kohë gramatikore.

Rasti i tretë:

Qu nian wo men chang - chang qu bei jing=Vitin e kaluar, ne shpesh shko në Peking!

Dallimi më i madh në kontekst të aspektit kohor, vërehet në kohët e kryera të kinezishtes.

Kjo për vetë faktin që kinezishtja nuk ka kohë të kryera foljore, por as mënyrë të të shprehurit të tyre, që realizohet nëpërmjet të ndonjë ndajfolje kohore-lokucion kohor, si ‘vitin e kaluar’ (qu nian). Ajo që është më e çuditshme është fakti se si shprehet ndojfolja e frekuencës në këtë gjuhë!

Pra, shpesh shkojmë=chang chang qu!

*Ka edhe mënyra të tjera se si shprehet koha gramatikore në kinezishte. Ajo është mënyra e përdorimit të aspektit foljor të foljeve kineze, që në fakt ka të bëjë me « aspectual particles = ndajfolje të llojeve të ndryshme ». Kjo na mundëson të bëjmë dallimin ndërmjet « Unë shkova në Peking (dje) ose në anglisht ; I went to Beijing (yesterday) dhe « Unë kam qe në Peking (më herët).

Përfundimi

Kinezishtja mandarine e ka aspektin kohor, ndryshe nga shqipja dhe anglishtja. Por prapëserapë, mund të konstatohet që ajo nuk i ka kohët gramatikore, për ta shprehur në mënyurë precize efektin kohor të foljeve. Ajo që duhet mbajtiur mend është fakti që kinezishtja nuk ka i ka kohët e kryera gramatikore. Për me tepër, ajo nuk i ka kohët gramatikore aspak. Po ajo që është evidente, është egzistimi i **aspektit gramatikor = grammatical aspect**, që në fakt mundëson formulimin semantik dhe gramatikor të së njëjtë, nëpërmjet përdorimit të fjalëve të ndryshme, si : ndajfolja, emri, parafjala etj. Gjenerativizmi konstruktivist i gramatikës gjenerative të Chomsikt, është disi me abstrakt në formulimin e këtyre ‘kohëve problematike’.

Kjo nga fakti që në gjenerimin e tyre, gjërat disi janë jo të prekshme lehtë, sepse kërkojnë logjikën në kontekst të diskursit. Në praktikën e komunikimit, qoftë ai i shkruar apo i folur, edhe folësi edhe dëgjesi, duhet patjetër të përqëndrohen në gjenerimin e strukturave që imponojnë aspektin gramatikor të nevojshëm, sipas pikëpamjes logjike, gjithnjë të kontrolluar dhe udhëhequr nga aspekti kohor i foljes, i cili gjithnjë duhet të jetë funksional dhe mbi të gjitha, logjik.

Bibliografia

- Chen, Keh-Jiann, Shu-Ling Huang, Yueh-Yin Shih, Yi-Jun Chen, 2005, Extended-HowNet: A Representational Framework for Concepts, Proceedings of Ontolex 2005, pp.1-6.
- Chen, Yi-Jun, S. Huang, Y. Shih, and K. Chen, 2005, Semantic Representation and Definitions for Function Words in Extended-HowNet. Workshop on Chinese Lexical Semantics, Xiamen, University, (in Chinese).
- Dong, Zhendong & Dong Qiang, HowNet, <http://www.keenage.com/> Fellbaum, Christiane, 1998, WORDNET-An Electronic Lexical Database, the MIT Press. <http://wordnet.princeton.edu> Chao, Yuen Ren. 1968.
- Hong Wei-mei. 1991. Comparative Structure in Mandarin Chinese. Unpublished master's thesis, National Tsing Hua University, Hsingchu, Taiwan.
- Hsing, Jen-chieh, 2003, On Comparative Sentences with Bi-marker in Mandarin Chinese, Unpublished master's thesis, National Tsing Hua University, Hsingchu, Taiwan.
- Li, Charles. N., S. A. Thompson. 1981. Mandarin Chinese: A functional Reference Grammar. Berkeley and Los Angeles: University of California Press.
- Liao, Wei-wen, 2005, The Comparative Construction and the Wh-Movement, ust working papers in linguistics, Volume 1, 187-200.